

Niveli lokal :

1. Njësia për të drejtat e njeriut (Zyrtarja për Barazi gjinore)

PROGRAMI I KOSOVËS PËR BARAZI GJINORE 2008-2013

Është program strategjik për integrimin e barazisë gjinore në politikat dhe programet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Programi duhet t'i ndihmojë institucionet e qeverisë së Kosovës për adresim të çeshtjeve të barazisë gjinore (historike, ekonomike, sociale, kulturore, politike).

Barazia gjinore, është e njohur edhe si barazi seksuale apo barazi e gjinive që nënkupton se burrat dhe grata duhet të kenë trajtim të barabartë.

Koncepti është i bazuar në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, dhe qëllimi baze është të sigurojë barazi në ligj dhe në gjendjen sociale, sidomos në aktivitetet demokratike.

Disenjoi Erodita Klaiqi Kasumi
Designed by



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gnjilane
Gilan Belediyesi

Dhuna në familje dhe çështjet pronësore

"Së bashku t'a eliminojmë dhunën në familje në baza gjinore



KUVENDI KOMUNAL GJILAN
Njësija për të drejtat e njeriut.
Zyrtarja komunale për Barazi gjinore
Drita Klaiqi

Tel: 044 873 203

Hyrje

Duke u bazuar në ligjin e trashëgimisë nen 3 parag.1

“Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjtë janë të barabartë në trashëgimi

Një grua pavarësisht nga statusi i saj social ose pozita familjare, është e barabartë me burrin e saj ose me vëllane ,mirepo në shumicën e rasteve gruja rradhë e realizon këtë të drejtë duke renë në ndikimin e praktikave zakonore dhe sociale apo si viktim e dhunës psikike e ushtruar nga personat të lartepermendur (burrit,vëllau).

Gratë si ndërtuese të paqes dhe duke qenë të vetëdijshme për pasojat me të cilat mund të perballen nëse ato kërkojnë realizimin e të drejtave të trashëgimisë së tyre pronësore dhe duke mos qenë të sigura se a do të viktimizohen për të dytën herë nga ana e institucioneve që e drejta e tyre do të realizohet hezitojn që të kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre në bazë të legjislacionit .

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Bazohet në parimet e barazisë para ligjit, të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesmarjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesmarrësve të tyre (Neni 3.2).

Republika e Kosovës siguron BARAZINË GJINORE si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqrisë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore (Neni 7.2). Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë

ligjore pa diskriminim (Neni 24).

Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e Barazisë gjinore të cilat janë të pranuara në pajtim me parimet ndërkombëtare (Neni17.2). Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë te pranuara ndërkombëtarisht (Neni101.1).

LJIGJI PËR TRASHËGEMIN I KOSOVËS-2005/7.

Femrat dhe mashkujt kanë të drejta të barabarta ne trashëgimi.

Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjtë janë të barabartë në trashëgimi (Neni3.1).

LIGJI PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJJE 2010/3.

Ndalohet përdorimi i çfarëdo lloji të dhunës në familje.

Duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar(Neni 1).

LJIGJI PËR BARAZI GJINORE 2004/2

Femrat dhe mashkujt kanë të drejta te barabarta në çdo fushë.

Ligji për Familjen e Kosovës 2004/32.

Femrat dhe mashkujt kanë të drejta të barabarta, të lidhin martesë dhe të krijojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësise apo religionit (Neni 14.1.2).

Ligji I punës 2010.

Punëdhënsit, duhet të krijojnë kushte të barabarta për të dy gjinjtë.

Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë 2002/2.

MASHT dhe Komunat marrin masa të siguronjë që personeli të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit përfshirë diskriminimin në baza gjinore (Neni 33.3).

Ligji per arsimin e lartë në republikën e kosovës –Nr.04/I-031-2011.

Garantohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim.(Neni 1.3).

Ligji për botimin e tesksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik- Nr.02/L-67-2006.

Nuk lejohen tekste shkollore, mjete mësimore, lektyrat shkollore dhe dokumentacioni pedagogjik që bëjnë propagandë kundër Kosovës , që cenojnë të drejtat e njeriut dhe BARAZINË GJINORE dhe që nxisin urrejtje politike, nacionale dhe fetare.(Neni 3.2).

Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi në bazë të gjinisë parashihet në të gjitha ligjet në vijim dhe shumë ligje tjera.

-LIGJI PËR ZGJEDHJE LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS -2008

-LIGJI PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS -2008

-LIGJI PËR SHËNDETËSI -2004

-LIGJI PËR PROCEDURËN ADMINISTRATIVE-2005

-LIGJI PËR VETËQEVERISJEN LOKALE-2008

-RREGULLORE PËR NDIHMË JURIDIKE -2006

MEKANIZMAT LIGJOR TË NGARKUAR PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR BARAZI GJINORE

Niveli qendror:

1. Agjencia për Barazi Gjinore
2. Zyra Këshillëdhënëse për qeverisje të mirë ,të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe për çështje gjinore
3. Njësia për të drejtat e njeriut në të gjitha ministrit e Kosovesë
4. Njësia për Barazi gjinore në kuadër të avokatit të popullit
5. Këshilli ndërministror për barazi gjinore
6. Partitë politike
7. Shoqëria Civile
8. Mediat.